

VENDIM
Nr. 541, datë 18.6.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË
MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE DHE STRUKTURAVE TË
MENAXHIMIT INDIREKT TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EVROPIAN, NË
KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT IPA II
(2014 – 2020)**

(Ndryshuar me vendimin nr. 118, datë 27.2.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 11, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA II, ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, me propozimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Integritetit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi dhe fusha e veprimit

a) Ky vendim përcakton funksionet e përgjegjësitë dhe krijon marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet autoriteteve dhe strukturave, për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit (këtej e tutje menaxhimi indirekt/MI), për zbatimin e Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit të Bashkimit Evropian, Programi IPA II (2014-2020).

b) Lidhur me dispozitat mbi programet e bashkëpunimit ndërkufitar dhe programin e zhvillimit në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, këto programe do të miratohen me vendime të veçanta, të posaçme, të Këshillit të Ministrave.

c) Ky vendim garanton që, nën menaxhimin indirekt të Programit IPA II, autoriteteve u ngarkohen përgjegjësi për një aktivitet, në lidhje me menaxhimin, zbatimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin apo auditimin e programeve. Autoritetet duhet të mundësojnë ushtrimin e detyrave që shoqërojnë këtë përgjegjësi, duke përfshirë rastet ku nuk ka lidhje hierarkike ndërmjet tyre dhe organeve pjesëmarrëse në atë aktivitet. Në ushtrimin e këtyre funksioneve, këta autoritete duhet të krijojnë:

i) marrëdhënie formale të punës ndërmjet tyre dhe organeve përkatëse;

ii) një sistem të përshtatshëm për shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar informacion dhe të drejtën e aksesit në dokumentacion dhe në staf, nëse është e nevojshme;

iii) standardet që duhen përmbushur dhe procedurat që duhen ndjekur.

Të gjitha raportet, vlerësimet dhe dokumentet e tjera, që lidhen me përgatitjen dhe zbatimin e programeve IPA II, të cilat i dorëzohen Komisionit Evropian, do të hartohen në gjuhën angleze.

2. Strukturat dhe autoritetet e menaxhimit indirekt

Me qëllim menaxhimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e asistencës së IPA II, krijohen strukturat dhe autoritetet e mëposhtme:

a) Koordinatori Kombëtar i IPA-s (KKIPA);

b) Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA);

c) Struktura e menaxhimit përgjegjëse para ZKA-së, e përbërë nga:

i) Fondi Kombëtar; dhe

ii) Zyra mbështetëse e ZKA-së.

ç) Struktura operative, e përbërë nga:

i) Drejtoria e Financimeve dhe Kontraktimeve (DFK);

ii) Strukturat përgjegjëse/njësitë për menaxhimin e programeve IPA II, në ministritë e linjës dhe/ose në institucionet përfituese;

iii) Zyra mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s.

d) Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian.

3. Funksionet dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (KKIPA)

a) Koordinatori Kombëtar i IPA-s (këtej e tutje KKIPA) është ministri përgjegjës për integrimin evropian.

b) KKIPA është një autoritet i menaxhimit indirekt, që do të jetë struktura homologe e Komisionit Evropian për të gjithë procesin e planifikimit strategjik, bashkërendimin e programimit, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA II. KKIPA ka këto detyra kryesore:

i) Garanton bashkërendimin, brenda administratës shqiptare, me donatorët e tjerë, dhe sinkronizon lidhjen e ngushtë ndërmjet përdorimit të asistencës IPA II dhe procesit të anëtarësimit;

ii) Merr masa për të siguruar që objektivat e vendosura në programet e veprimit, për të cilat janë besuar detyrat e zbatimit të buxhetit, të jenë adresuar siç duhet gjatë zbatimit të asistencës IPA II;

iii) Koordinon, në zbatim të nenit 57, të marrëveshjes kuadër, ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, hartimin e një plani vlerësimi, në konsultim me Komisionin Evropian, ku do të paraqiten aktivitetet vlerësuese që do të kryhen në faza të ndryshme të zbatimit të asistencës IPA II;

iv) Përpiqet që administrata shqiptare të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e programeve përkatëse;

v) Siguron që objektivat e vendosura në veprimet apo programet e propozuara nga administrata shqiptare të jenë në koherencë me objektivat e dokumenteve tregues të strategjisë;

vi) Merr masat për të siguruar pronësinë e programimit dhe implementimit të asistencës IPA II nga përfituesi;

vii) I paraqet Komisionit Evropian raportet e kërkuara, lidhur me zbatimin e detyrave që i janë besuar, dhe siguron monitorimin në nivel projekti dhe programi;

viii) Konfirmon, së bashku me ZAK-un dhe titullarin e Autoritetit Auditues, gatishmërinë për të realizuar funksionet dhe përgjegjësitë që u janë ngarkuar, sipas shtojcës A, të marrëveshjes kuadër, ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, për çdo Program Kombëtar IPA II;

ix) I dorëzon Komisionit Evropian, deri më 15 shkurt të vitit financiar pasardhës, një raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II dhe një raport vjetor mbi zbatimin e detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit, sipas neneve 58 e 59, të marrëveshjes kuadër, ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, të IPA II.

c) KKIPA, në bashkëpunim me shërbimet e Komisionit Evropian (përfshirë Zyrën e Delegacionit të BE-së në Tiranë), identifikon proritetet për mbështetje, përmes një programi vjetor ose shumëvjeçar specifik, bazuar në Dokumentin e Strategjisë Kombëtare (DSK 2014-2020), si dhe në dokumentet e tjera strategjike kombëtare. Më pas, KKIPA i diskuton këto prioritetet me Departamentin e Zhvillimit, Programimit, Financimit dhe Ndhimës së Huaj, pranë Këshillit të Ministrave, dhe i dërgon për miratim në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS). KKIPA informon Komisionin Evropian për prioritetet përfundimtare të dakordësuara për financimin e IPA-s, të miratuara nga KPS-ja.

4. Funksionet dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA)

a) Zyrtari Kombëtar Autorizues (këtej e tutje ZKA) është zëvendësministri i Financave.

b) ZKA-ja ka përgjegjësinë e plotë për menaxhimin financiar të asistencës së IPA II në Shqipëri dhe për garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së shpenzimeve.

c) ZKA-ja është përgjegjës, veçanërisht, për:

i) menaxhimin financiar të fondeve IPA II si dhe të operacioneve financiare, në përputhje me dispozitat e parashikuara në pikat 2 e 3, të nenit 2, të aneksit A, të marrëveshjes kuadër, ratifikuar me ligjin nr. 37/2015;

ii) funksionimin efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm, për zbatimin e asistencës IPA II, në përputhje me dispozitat e parashikuara në anekset A, pikat 2 e 4, dhe B, të marrëveshjes kuadër, ratifikuar me ligjin nr. 37/2015;

iii) vendosjen e masave efektive dhe antimashtim, duke marrë parasysh risqet e identifikuar;

iv) aplikimin dhe dorëzimin, pranë Komisionit Evropian, të kërkesës për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit, në kuadrin e një programi apo mase të caktuar, në përputhje me nenin 13, të marrëveshjes kuadër, ratifikuar me ligjin nr. 37/2015;

v) hartimin dhe dorëzimin pranë Komisionit Evropian dhe KKIPA-s, deri më 15 shkurt të vitit financiar pasardhës, të dokumentacionit, sipas kërkesave të parashikuara në pikat 2 e 6, të nenit 59, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015;

vi) vendosjen dhe miratimin e rregullave e procedurave, nëpërmjet Marrëveshjes Implementuese, me KKIPA-n dhe DFK-në;

vii) bashkëpunimin me strukturën e inspektimit financiar, të ngritur në Ministrinë e Financave, që vepron si Njësia e Shërbimit të Koordinimit Kundër Mashtrimit (AFCOS), me qëllim parandalimin, zbulimin, raportimin, investigimin dhe ndjekjen e parregullsive. Marrëdhëniet e ndërsjella, që rregullojnë menaxhimin e parregullsive dhe ndjekjen e tyre në gjyqësor, rregullohen me memorandumin e bashkëpunimit, ndërmjet ZKA-së dhe Drejtorisë së Inspektimit Financiar (AFCOS) dhe ndërmjet ZKA-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë;

viii) ngritjen e një strukture menaxhimi, e përbërë nga Fondi Kombëtar dhe Zyra Mbështetëse e ZKA-së, dhe sigurimin e ndarjes së duhur të detyrave dhe përgjegjësisë ndërmjet tyre;

ix) miratimin e manualit të procedurave për strukturat menaxhuese dhe operative; të marrëveshjeve operacionale, ndërmjet organeve, pjesë përbërëse të strukturës operative, planit vjetor të trajnimeve për stafin e menaxhimit indirekt, planit të rekrutimit dhe çdo procedure tjetër që lidhet me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin.

ç) Ndarja e roleve dhe përgjegjësisë, ndërmjet ZKA-së, FK-së, Zyrës Mbështetëse të ZKA-së e DFK-së, dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, përcaktohen në një marrëveshje zbatuese, që përshkruan të gjitha rolet dhe përgjegjësitë e palëve, procedurat e transferimit dhe metodat për përdorimin e fondeve, dispozitat që lidhen me bashkëfinancimin, mekanizmat e kontrollit financiar, menaxhimin e llogarive bankare, kontabilitetin dhe auditimin.

5. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës së menaxhimit

Struktura menaxhuese, e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA-së, për zbatimin e programit IPA II, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualin e brendshëm të procedurave dhe rregulloren e brendshme të Ministrisë së Financave.

5.1. Fondi Kombëtar

a) Fondi Kombëtar është strukturë në Ministrinë e Financave. Ai ka kompetenca qendrore buxhetore dhe vepron si subjekt qendror i thesarit, mbështet ZKA-në në përmbushjen e detyrave të tij/saj, në veçanti ato të menaxhimit të llogarive të IPA II, dhe operacionet financiare të përcaktuara në nënndarjen “i”, të shkronjës “c”, të pikës 4, më sipër, dhe është përgjegjës për

detyrat e menaxhimit financiar të asistencës IPA II, nën përgjegjësinë e ZKA-së.

b) Fondi Kombëtar është, veçanërisht, përgjegjës për këto detyra:

i) Mban dhe organizon llogaritë bankare qendrore të IPA-s;

ii) Kërkon fonde dhe merr të gjitha pagesat nga buxheti i BE-së;

iii) Kërkon fonde dhe merr të gjitha pagesat nga buxheti i shtetit për elementet e bashkëfinancimit, sipas rastit;

iv) Autorizon transferimin e këtyre pagesave të strukturat operative ose të marrësit;

v) Kthen fondet në buxhetin e BE-së, pas lëshimit të urdhrave të kthimit nga Komisioni Evropian;

vi) Mbështet ZKA-në në përgatitjen e raportimit financiar për Komisionin Evropian, siç përcaktohet në marrëveshjen financiare;

vii) Mban sistem kontabël kompjuterik (Accrual) që jep informacion të saktë, të plotë dhe të besueshëm, në kohën e duhur.

c) Gjatë përmbushjes së përgjegjësisë së tij, lidhur me menaxhimin financiar të IPA II, Fondi Kombëtar bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë, bazuar në një marrëveshje të posaçme, që rregullon afatet dhe kushtet për funksionimin e llogarive, në monedhën vendase dhe të huaj, të hapura në Bankën e Shqipërisë.

ç) Kur është e nevojshme, Fondi Kombëtar kryen verifikime në vend për të siguruar menaxhim efektiv dhe efikas financiar të llogarive IPA II dhe të operacioneve financiare.

5.2. Zyra mbështetëse për ZKA-në

a) Zyra mbështetëse për ZKA-në është strukturë në Ministrinë e Financave, nën përgjegjësinë e ZKA-së, në përmbushje të përgjegjësisë së tij/saj për funksionimin efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm, për zbatimin e asistencës IPA II.

b) Zyra mbështetëse për ZKA-në është, veçanërisht, përgjegjëse për të mbështetur ZKA-në në përmbushjen e detyrave në vijim:

i) Garantimin e një niveli sigurie për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve themeltare;

ii) Vendorsjen e masave efikase dhe antimashtim, duke marrë parasysh risqet e identifikuar, dhe garantimin e raportimit, sipas dispozitave të pikës 2, të nenit 51, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, duke e mbajtur të informuar shërbimin e koordinimit antimashtim (AFCOS).

iii) Monitorimin dhe përmbushjen, në vijimësi, nga struktura menaxhuese dhe strukturat operative, të kërkesave, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “d”, të pikës 3, të nenit 12, dhe në shtojcën B, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, dhe, në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave, për informimin, pa vonesë, të Komisionit Evropian dhe për marrjen e masave mbrojtëse, të përshtatshme, në lidhje me pagesat e kryera ose kontratat e nënshkruara;

iv) Ngritjen dhe sigurimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm efektiv dhe efikas, duke marrë parasysh:

- mjedisin e kontrollit;

- menaxhimin e riskut;

- aktivitetet e kontrollit;

- informimin dhe komunikimin;

- monitorimin e kuadrit të kontrollit të brendshëm;

- sigurimin e raportimit për sistemet e menaxhimit të kontrollit dhe vlerësimin e kapaciteteve të stafit për programim dhe implementim, në strukturat operative të përfshira në këto procedura;

- garantimin e funksionimit të një sistemi të përshtatshëm raportimi dhe informimi;

- ndjekjen e konstatimeve të raporteve të auditit, të kryera nga Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian, dhe sigurimin e informacionit të vazhdueshëm për ZKA-në, me qëllim marrjen e vendimeve;

- mbajtjen parasysht, gjatë përgatitjes së deklaratës vjetore të menaxhimit, siç parashikohet në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 59, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, të rezultateve të auditeve të kryera nga ose nën përgjegjësinë e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian;

- njoftimin, menjëherë, të Komisionit Evropian për ndonjë ndryshim thelbësor, në lidhje me sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, për shqyrtimin dhe miratimin, paraprak, të zbatimit të tyre;

- bashkërendimin, kur është e nevojshme, për përgatitjen e planeve të veprimit të konsoliduara, duke adresuar dobësitë e identifikuar në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit;

- kyerjen e verifikimeve në vend, kur është e nevojshme, për të siguruar funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm.

6. Funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian është një strukturë, nga pikëpamja funksionale dhe financiare, e pavarur dhe funksioni e përgjegjësitë e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

7. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës operative

a) Struktura operative është përgjegjëse për zbatimin, informimin dhe vizibilitetin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e progra-meve, sa herë që paraqitet e nevojshme, në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar, dhe është përgjegjëse për garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsinë e shpenzimeve të kryera për zbatimin e programeve nën përgjegjësinë e saj.

b) Struktura operative përbëhet nga:

i) Drejtoria e Financimeve dhe Kontraktimeve (DFK), në Ministrinë e Financave;

ii) njësitë e menaxhimit të fondeve të IPA-s, në ministritë e linjës dhe/ose institucionet përfituese;

iii) zyra mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s.

c) Detyrat specifike të çdo organi që përbën strukturën operative përcaktohen dhe rregullohen me një marrëveshje operacionale, ndërmjet KKIPA-s, drejtuesit të DFK-së dhe drejtuesit të njësive të menaxhimit të fondeve IPA, në ministritë e linjës dhe/ose institucionet përfituese.

ç) Drejtori i DFK-së, përveç përgjegjësisë së tij/saj për DFK-në, është përgjegjës për mbikëqyrjen e menaxhimit teknik të projekteve IPA II, që zbatohen nga strukturat përgjegjëse/njësitë për menaxhimin e programeve IPA II, në ministritë e linjës dhe/ose në institucionet përfituese, si dhe për monitorimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në strukturat IPA.

7.1. Përgjegjësitë e strukturës operative

a) Për zbatimin e programit, struktura operative:

i) monitoron zbatimin e tij; propozon amendamente, sipas nevojës; siguron informacion për komitetin monitorues sektorial, për ecurinë e programit në arritjen e objektivave të tij, veçanërisht, në bazë të standardeve dhe treguesve (objektivat), si dhe të dhënat financiare;

ii) jep të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e raporteve nga KKIPA dhe ZKA-ja, të cilat i paraqiten Komisionit Evropian, siç parashikohet në nenin 59, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015. Stukturës operative mund t'i kërket të hartojë një raport të hollësishëm vjetor, që mbulon vitin e plotë financiar, i cili i dërgohet Komisionit Evropian nga KKIPA, pas shqyrtimit nga komiteti monitorues sektorial përkatës;

iii) shkëmben, brenda strukturës operative, çdo informacion të rëndësishëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara dhe për zbatimin e veprimeve;

iv) është përgjegjëse për hartimin e planit të vlerësimit dhe kryerjen, sipas nevojës, të vlerësimeve ex-ante, të ndërmjetme dhe ex-post të programeve që ajo menaxhon, në zbatim të dispozitave të nenit 55, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015.

b) Në lidhje me përzgjedhjen, kontrollin e veprimeve dhe menaxhimin financiar, në përputhje me nenet përkatëse të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, struktura operative:

i) garanton që veprimet janë zgjedhur për financimin dhe janë miratuar në përputhje me procedurat dhe kriteret e zbatueshme për fushën e politikës ose programit;

ii) organizon procedurat për prokurimin, dhënien e granteve dhe kontraktimin;

iii) krijon procedura për të garantuar mbajtjen e të gjitha dokumenteve, në lidhje me prokurimin, dhënien e granteve, kontraktimin, menaxhimin financiar, kontrolleve dhe auditeve që kërkohen për të siguruar gjurmë adekuate auditimi;

iv) kryen pagesa për/dhe kthimin nga marrësit të asistencës IPA II;

v) garanton që të gjitha organet e strukturës operative, të përfshira në zbatimin e veprimeve, të mbajnë sistem të veçantë ose kodifikim të përshtatshëm kontabiliteti për të gjitha transaksionet, në lidhje me një veprim;

vi) garanton që ZKA-ja (Fondi Kombëtar dhe Zyra Mbështetëse e ZKA-së) të marrë të gjitha informacionet e nevojshme për procedurat dhe verifikimet e menaxhimit të shpenzimeve;

vii) krijon bazën e sistemit të kontabilitetit aktual, e cila regjistron dhe ruan, në formë të kompjuterizuar, të dhënat e kontabilitetit për çdo veprim/aktivitet dhe mbështet të gjitha të dhënat e nevojshme për hartimin e kërkesë-pagesës dhe raportit ose pasqyrës vjetore financiare dhe marrjen e angazhimeve, pagesave e monitorimin e zbatimit të veprimit;

viii) krijon sistemin për raportimin në kohë të parregullsive dhe për masat efektive e të antimashtrimit, duke marrë parasysh risqet e identifikuara;

ix) krijon sistemin për njohjen e të gjitha shumave që janë për t'u paguar dhe për regjistrimin e tyre në librin e debitorëve, duke përfshirë parregullsitë, para pranimi të tyre;

x) verifikon që shpenzimet e kryera, të paguara dhe të deklaruara te ZKA-ja përputhen me legjislacionin e zbatueshëm, të brendshëm dhe atë të BE-së, programin, kushtet për mbështetjen e veprimit dhe kushtet e kontratës; që mallrat ose shërbimet janë dorëzuar dhe pagesat e kërkuara nga marrësit janë të sakta.

Këto verifikime mbulojnë aspektet administrative, financiare, teknike dhe fizike të çdo veprimi dhe përfshijnë:

- verifikimin e plotë administrativ të të gjitha dokumenteve mbështetëse, në lidhje me çdo angazhim dhe pagesë;

- verifikime fizike në vend, frekuenca dhe shtrirja e të cilave merr parasysh, ndër të tjera, llojin e veprimit, shumën e shpenzimeve publike të përfshira dhe nivelin e riskut të identifikuar;

xi) garanton respektimin e kërkesave për informimin, publicitetin, transparencën, vizibilitetin dhe komunikimin, siç parashikohet në nenet 23 e 24, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015.

xii) garanton raportimin e parregullsive.

8. Komiteti monitorues i IPA-s

a) Brenda gjashtë muajve, pas hyrjes në fuqi të së parës marrëveshje financimi, në përputhje me nenin 52, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, Komisioni Evropian dhe qeveria shqiptare do të ngrenë një komitet monitorimi të IPA-s.

b) Komiteti monitorues i IPA-s shqyrton efikasitetin, efektshmërinë, cilësinë, koherencën,

bashkërendimin dhe përputhshmërinë e zbatimit të veprimeve për përmbushjen e objektivave të parashikuara në marrëveshjet financiare dhe në dokumentet strategjike të vendit. Për këtë qëllim, ky komitet bazohet, sipas rastit, në informacionin e marrë prej komiteteve monitoruese sektoriale dhe jep rekomandime për masa korrigjuese, nëse është e nevojshme.

c) Komiteti monitorues i IPA-s mund t'i paraqesë propozime Komisionit Evropian, KKIPA-s dhe ZKA-së për të garantuar koherencë dhe bashkërendim më të mirë të asistencës IPA II, siç parashikohet në dokumentet strategjike të vendit, dhe, sipas rastit, në dokumentet strategjike shumëvendëshe apo në rregulloren IPA II, si dhe për të forcuar efikasitetin, efektivitetin, impaktin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të kësaj asistence. Gjithashtu, komiteti monitorues i IPA-s mund t'u rekomandojë komiteteve monitoruese sektoriale masa korrigjuese, me qëllim që të garantohet përmbushja e objektivave të IPA II dhe të forcohet efikasiteti dhe efektiviteti i asistencës IPA II. Për këtë qëllim, sipas rastit, ai do të marrë parasysh përfundimet dhe rekomandimet e nxjerra nga monitorimet dhe vlerësimet e kryera si nga Komisioni Evropian ashtu edhe nga qeveria shqiptare.

ç) Komiteti monitorues i IPA-s miraton rregulloren e tij të brendshme bashkërisht me KKIPA-n, ZKA-në dhe Komisionin Evropian.

d) Komiteti monitorues i IPA-s përbëhet nga përfaqësues të Komisionit Evropian, KKIPA-s dhe organeve e autoriteteve kombëtare përkatëse të përfituesit IPA II dhe, sipas rastit, organizatave ndërkombëtare, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe grupet e interesit, si shoqëria civile dhe organizatat e sektorit privat. Përfaqësuesit e grupeve të interesit zgjidhen sipas rregullave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren e brendshme të komitetit monitorues të IPA-s dhe në marrëveshje me Komisionin Evropian. Mbledhjet e komitetit monitorues të IPA-s bashkëkryesohen nga një përfaqësues i Komisionit Evropian dhe një përfaqësues i KKIPA-s.

dh) Komiteti monitorues i IPA-s mbledhet, të paktën, një herë në vit. Takime të posaçme mund të zhvillohen me nismën e Komisionit Evropian apo KKIPA-s, sidomos mbi bazë tematike.

e) Në rastin e menaxhimit indirekt, kur komitetet monitoruese sektoriale nuk janë ngritur ende, sipas nenit 53, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, komiteti monitorues i IPA-s kryen të gjitha funksionet e renditura në shkronjën “c”, të kësaj pike.

9. Komitetet monitoruese sektoriale

a) Komitetet monitoruese sektoriale ngrihen nga administrata shqiptare (përfituesi i programit ose aksionit), për çdo fushë apo program përkatës, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e të parës marrëveshje financiare. Kur është e nevojshme, mund të ngrihen komitete monitoruese sektoriale të posaçme, që funksionojnë me metoda të tjera zbatimi.

b) Secili komitet monitorues sektorial shqyrton efikasitetin, efektshmërinë, cilësinë, koherencën, bashkërendimin dhe përputhshmërinë e zbatimit të aksioneve në fushën apo programin përkatës, si dhe qëndrueshmërinë e tyre me strategjitë kombëtare përkatëse. Ai mat progresin në përmbushjen e objektivave të masave, rezultateve dhe impakteve të pritshme të tyre, duke përdorur tregues që nisen nga skenarë bazë, si dhe progresin e bërë në ekzekutimin financiar. Komiteti monitorues sektorial i raporton komitetit monitorues të IPA-s dhe mund të bëjë propozime për masa korrigjuese, me qëllimin për të garantuar përmbushjen e objektivave, të aksioneve dhe për të rritur efikasitetin, efektshmërinë, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e asistencës.

c) Komiteti monitorues sektorial përbëhet nga përfaqësues të organeve dhe autoriteteve kombëtare përkatëse, grupeve të tjera të interesit, siç janë partnerët ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, si dhe organizatave ndërkombëtare, sipas rastit, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqërinë civile. Komisioni Evropian merr pjesë në aktivitetin e komiteteve. Mbledhjet e komitetit monitorues sektorial kryesohen nga një përfaqësues i lartë i institucionit përfitues. Në varësi të

fushës apo programit, mbledhjet e komitetit mund të bashkëkryesohen me Komisionin Evropian.

ç) Secili komitet monitorues sektorial miraton rregulloren e tij të brendshme.

Komitetet monitoruese sektoriale mblidhen, të paktën, dy herë në vit, por mund të zhvillohen edhe mbledhje të posaçme.

d) Bazuar në raportet që marrin prej strukturave operative, komitetet monitoruese sektoriale kryejnë, veçanërisht, këto detyra:

i) Shqyrtojnë progresin e bërë në arritjen e objektivave, të output-eve dhe rezultateve të planifikuara, si dhe në vlerësimin e impaktit dhe qëndrueshmërisë së aksioneve dhe programeve në vazhdim, ndërkohë që garantohet koherenca me dialogun e vazhdueshëm politik, strategjitë kombëtare dhe rajonale sektoriale përkatëse dhe aktivitetet shumëvendëshe dhe/ose rajonale në vend;

ii) Shqyrtojnë raportet vjetore të zbatimit, duke përfshirë ekzekutimin financiar të aksioneve;

iii) Shqyrtojnë konstatimet dhe përfundimet e duhura si dhe propozimet për masa korrigjuese, që lindin prej kontrolleve në vend, monitorimit dhe vlerësimit, nëse ka;

iv) Diskutojnë për aspektet e duhura të funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit;

v) Diskutojnë për çështjet problematike dhe aksionet;

vi) Nëse nevojitet, marrin në konsideratë ose bëjnë propozime për ndryshime në programe, si dhe çdo masë tjetër korrigjuese, për të garantuar përmbushjen e objektivave të masave dhe për të forcuar efikasitetin, efektshmërinë, impaktin dhe qëndrueshmërinë e asistencës IPA II;

vii) Shqyrtojnë masat e marra për informimin, reklamën, transparencën, vizibilitetin dhe komunikimin, në përputhje me nenet 23 e 24, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015.

dh) Konkluzionet operationale, duke përfshirë rekomandimet, nëse ka, hartohen në fund të mbledhjeve të komiteve monitoruese sektoriale. Këto përfundime janë objekt i ndjekjes së menjëhershme dhe shqyrtimi në mbledhjet pasardhëse të komitetit dhe përbëjnë bazën e raportimit pranë komitetit monitorues të IPA-s për progresin e bërë, sipas pikës 2, të nenit 52, të marrëveshjes kuadër, të ratifikuar me ligjin nr. 37/2015.

10. Komiteti ndërinstitucional për koordinimin e Programit IPA II (2014-2020)

a) Komiteti ndërinstitucional për koordinimin e Programit IPA II (2014-2020) është një grup pune ndërinstitucional, i ngritur në ministrinë përgjegjëse për integrimin evropian, bazuar në urdhrin e Kryeministrit, dhe shërben si një mekanizëm bashkërendues për monitorimin e implementimit të projekteve/programeve të IPA-s në fusha problematike.

b) Grupi i punës ndërinstitucional kryesohet nga KKIPA (ose një zyrtar tjetër i zgjedhur prej saj), me pjesëmarrjen e zëvendësministrave të ministrive të linjës, përgjegjëse për programet IPA, ZKA-ja, drejtuesi i Fondit Kombëtar, drejtuesi i Zyrës Mbështetëse të ZKA-së, drejtuesi i strukturës mbështetëse të KKIPA-s, drejtuesi i DFK-së, drejtuesit e njësive të menaxhimit të fondeve IPA, në ministrinë e linjës dhe/ose institucione të tjera, përfaqësues të Departamentit të Zhvillimit, Programimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

c) Komiteti ndërinstitucional për koordinimin e Programit IPA II është përgjegjës për hartimin dhe shqyrtimin e planit të veprimit apo masave që duhen marrë për çdo projekt / veprim / program problematik, të financuar nga programet IPA. Ky komitet mund të organizojë inspektime në vend për të monitoruar zbatimin e planit të veprimit.

ç) Në rastet e projekteve / veprimeve / programeve problematike, për të cilat nuk është marrë ndonjë masë, Komiteti ndërinstitucional për koordinimin e programit IPA II i propozon Komitetit të Planifikimit Strategjik masa konkrete për institucionet përfutuese.

d) Struktura mbështetëse e KKIPA-s shërben si sekretariat i Komitetit ndërinstitucional për koordinimin e programit IPA II.

11. Dispozita kalimtare

Ngarkohen ministritë dhe institucionet përfituese të IPA-s që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrin masat përkatëse për harmonizimin e rregulloreve të brendshme të institucioneve të tyre me dispozitat e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama